

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Next Promotion & Advertising“ SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 28.08.2024, I poshtëshënuari :

Vincenzo Samara i datelindjes 01.12.1991, shtetas Shqiptar ,mbajtes i Pasaportes Nr. J11201059P me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësitëkufizuar“**Next Promotion&Advertising”shpk**

*Neni 1*  
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**Next Promotion & Advertising “ shpk** , dhe formë ligjore:  
“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

*Neni 2*  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

*Neni 3*  
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë:  
Rruga Komuna e Parisit, Ndertesa Nr. 8, Hyrja 4, Kati 1, Nr. 5 Tirane

*Neni 4*  
Objekti i veprimtarisë

Reklama dhe promocione

*Neni 5*  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

*Neni 6*  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.

Kapitali i mesiperm është nënshkruar nga “ortaku i vetem i shoqërisë :

Vincenzo Samara, zoterues i 1 kuote që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitali themeltar të shoqërisë;

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme vetëm me rrugë trashëgimie. Transferimi i kuotave si ortakëve të shoqërisë ashtu edhe për personat e tjerë jashtë shoqërisë është i kushtëzuar me miratimin e Asamblesë.

### Neni 8

#### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 9

#### Administrimi

Administrator i shoqërisë është:

- Vincenzo Samara, i datelindjes 01.12.1991, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pasaportes Nr. J11201059P, emëruar në këtë detyrë për një arat 5 vjeçar me të drejtë ripërritje

### Neni 10

#### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në kete akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11  
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.  
Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues të shoqërisë tregtare “**Next Promotion & Advertising “shpk**”, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

Vincenzo Samara

A handwritten signature in blue ink, consisting of several vertical and diagonal strokes, with a long horizontal line extending to the right.